REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**VENDIM**

**Nr. 59, datë 23.12.2020**

**PËR LISTËN PËRFUNDIMTARE TË RENDITJES SË KANDIDATËVE PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, NË VENDIN VAKANT, VAKANCË E PARAKOSHME, E SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018, RISHPALLUR NË DATËN 27.09.2019 DHE RISHPALLUR NË DATËN 24.09.2020**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 5 të nenit 229, të pikës 2 të nenit 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si edhe të pikave 68, 70 dhe 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi dëgjoi relatimin e relatorit, znj. Vitore Tusha dhe si e bisedoi çështjen, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020, si më poshtë:

   1) Përparim Kalo 90.29 Pikë
   2) Aleksandër Toma 75.57 Pikë

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**ZËVENDËSKRYETARE**

**Vitore TUSHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI TIRANË